# DËSHMI ARKIVI

**A-446560**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "Do të dyfishohet bonusi për pensionistët" nga rritja nuk përfitojnë të gjithë, përjashtohen pensionet "e lar ta" |
| ADRESA | `https://a2news.com/shqiperia/ekonomi/do-te-dyfishohet-bonusi-per-pensionistet-nga-rritja-nuk-perfit-i1185120` |
| BURIMI | a2news.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 15:31:04 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 15:16:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2db6a54921eb190354d795073ca034fbf8dd279c0ee528c7b7a4ce4235ab60af` |
| TEKSTI | `571597cf6d5dd9971b197a44b64f627c02c80b072b6ec9a01c57e889a280a0e1` |
| PAMJA | `dbc787909ee7c815d52f51d34a8ccafaeacaf069e6348fd46c031f3e165ae616` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `742e9708608e7152724f6651cc1efa6f1917c2c2d695630029be1ecc7291e56f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/742e9708608e7152724f6651cc1efa6f1917c2c2d695630029be1ecc7291e56f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "Do të dyfishohet bonusi për pensionistët" nga rritja nuk përfitojnë të gjithë, përjashtohen pensionet "e larta"

Nga Marjo Brakaj
15 Shtator 2026, 17:16 | Ekonomi

Pensionistët do të përfitojnë rritje mujore nga 600 deri në 1 mijë e 800 lekë, sipas kategorive dhe nivelit të të ardhurave nga 1 janari 2027, por nga bonuset nuk do të përfitojnë të gjithë.

*"Në vitin 2026 nisëm bonusin mujor, ndërsa nga 1 janari 2027 ai do të dyfishohet për të gjitha kategoritë e pensionistëve, krahas vijimit të indeksimit të pensioneve. Për këtë mbështetje kemi parashikuar 22.4 miliardë lekë më shumë në buxhetin e vitit të ardhshëm, me objektivin që deri në vitin 2030 pensioni i plotë të mos jetë më pak se 40 mijë lekë dhe pensioni i pjesshëm jo më pak se 22 mijë lekë"*, tha Delina Ibrahimaj, ministre e Ekonomisë dhe Inovacionit.

Të moshuarit, nënat me shumë fëmijë apo ata që kanë të ardhura më pak se 40 mijë lekë në muaj do të marrin nga 1 mijë e 800 lekë shtesë çdo muaj.




Rritje me 800 lekë në muaj përfitojnë ata që marrin pensin pleqërie të pjesshëm apo që përfitojnë strehim social nën 22 mijë lekë në muaj.




TË FUNDIT
Sa i kushtoi Kosovës mbrojtja e të akuzuarve në Hagë?
Gjykata la në burg Veliajn, Rama: Tirana sërish pa kokë, banorët po paguajnë haraçin
Politikanët në "darët" e SPAK, Gjykata e Lartë nuk liron Erion Veliajn, GJKKO Ilir Metën
Goditet grupi shqiptar i kokainës, 8 të ndaluar në Belgjikë, i përfshirë edhe Gerd Gjinarari
MË TË VIZITUARAT
50 vite burg për 7 vetë, plani për vrasjen e ish-deputetit, dënohet Durim Bam...
Rrogat sërish në Kushtetuese, magjistratët kundërshtojnë në Kuvend formulën e...
Procesi ndaj Thaçit në Hagë, ambasadori kroat: Të shikohet në kuadrin juridik...
LIVE UPDATES
Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë
LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore
Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Pension për shkak të profesionit

**Kushti: Marrin më pak se 40.000 lekë /muaj**

Rritje me 1 mijë lekë në muaj do të përfitojnë pensionistët në fshatra, ish-kooperativistët të cilët marrin më pak se 18 mijë lekë në muaj.

Por nga shtesa nuk do të përfitojnë të gjithë. Në fshat kur merr mbi 18 mijë lekë nuk përfiton shtesë e po ashtu dhe pensionistët në qytet që kanë më shumë se 22 mijë lekë të ardhura.

## PENSIONISTËT QË PËRFITOJË RRITJE 800 LEKË/MUAJ

Pension pleqërie të pjesshëm

Personat që përfitojnë pension social

**Kushti: Marrin më pak se 22.000 lekë /muaj**

Të përjashtuar nga rritja janë edhe përfituesit e pensionit familjar që marrin mbi 18 mijë lekë në muaj. Ata që marrin më pak se kjo shumë do të përfitojnë 700 lekë në muaj.

E njëjta vlen edhe për përfituesit e pensionit të invaliditetit që marrin mbi 30 mijë lekë në muaj. Kush merr më pak se kjo shumë përfiton 600 lekë në muaj rritje.

## PENSIONISTËT QË PËRFITOJË RRITJE 1.000 LEKË/MUAJ

Pensione rurale

Ish-kooperativistë

**Kushti: Të ardhura deri në 18.000 lekë/muaj**

Në total do të marrin bonus mujor 727 mijë pensionistë nga në vend janë gati 770 mijë që janë në total. Vetëm 36 për qind e tyre do të marrin 1800 lekë në muaj, pasi pjesa dërrmuese gati 41 për qind do marrin 800 lekë, ndjekur nga 10.3 për qind që do të marrin 1 mijë lekë, e pjesa tjetër janë në vlerat 600-700 lekë.

## PENSIONISTËT QË PËRFITOJË RRITJE 700 LEKË/MUAJ

Pension familjar

**Kushti: Marrin më pak se 18.000 lekë /muaj**







**(A2 Televizion)**

**Galeria fotografike ()**




**A2 CNN Livestream**





MUND TE LEXONI GJITHASHTU

Shtyhet sërish Censi i Bujqësisë: Nuk ka buxhet, do të realizohet vitin e ardhshëm

Pompa e shtrenjtë shqiptare, nafta deri 45% mbi rajonin, shkak taksat

Hall me bord e hall pa bord! Nafta drejt 230 lekë për litër, qeveria rri duarkryq

Bie sërish Euro, prek minimumin e ri historik

Ndryshon ligji për legalizimet, kushte për zonat ku parashikohet ndërtimi i pallateve

Specialistët e Kadastrës "zbarkojnë" në Piqeras, po punohet për evidentimin e regjistrit kadastral

## Latest Videos




"Për të ardhur keq që Shqipëria e ka çmimin të shtrenjtë pas Norvegjisë dhe Suedisë"




Gjykata la në burg Veliajn, Rama: Tirana sërish pa kokë, banorët po paguajnë haraçin









Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.